REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Adresa: Bulevardi "AbdiToptani", nr. 1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al

Nr. 1263/7 Prot. Tiranë, më 24/04/2018

V E N D I M

Nr. 30, datë 24.04.2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUARNË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT,TIRANË
"MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË"
PËR PERIUDHËN PREJ DATËS 01.01.2014 DERI NË DATËN 31.12.2017

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, u konstatuan të meta dhe mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, të cilat më hollësisht trajtohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimiti Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",*

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë", nëDrejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit,Tiranë, sipas Programi të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1263,/1 datë 06.12.2017, i ndryshuar me shkresën nr. 1263/2, datë 12.02.2017, për veprimtarinë e këtij institucioni për periudhën nga data 01.01.2014 deri në datën 31.12.2017.

II.Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITIMIT

[shqiptaria.com]

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisënë Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit,Tiranë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale për nga sasia, **por janë materiale për nga konteksti**[1], të cilat konsistojnë si më poshtë:

1. Nga auditimi konstatohet se, DPRMSH gjatë periudhës së auditimi nëpërmjet ankandeve të realizuara, ka shitur për skrap rreth 5,200 mjete të ndryshme (autovetura dhe kamionë) me peshë totale prej 4,732 ton. Në përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit për shitje në formë skrapi të këtyre mjeteve motorike nuk është përcaktuar pesha e metaleve me ngjyrë, të cilat zënë rreth 10 % të peshës totale të skrapit të shitur. Mosrespektimi i bazës ligjore nga Autoriteti Shitës, ka sjellë si pasojë të ardhura potenciale të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën prej 100,000,000 lekë.

2.Nga auditimi u evidentuamosrespektim të akteve ligjore dhe nënligjore, mangësi në lidhjen e kontratave dhe mos bashkëpunim më Avokaturën e Shtetit në lidhje me hartimin e kontratave të ankandit për shitjen e mjeteve për qarkullim dhe për skrap të cilat kanë vlera të konsiderueshme nga 5 deri 40 milionë lekë, duke sjellë si pasojë që, mjetet në formë skrapi të shiten pa marrë asnjë konfirmim në se janë çregjistruar nga DPSHTR.Kjo mënyre veprimi lë shteg për tjetërsim të mjeteve nga objekt skrapi në mjete për qarkullim apo edhe favorizim për veprimtari të jashtëligjshme dhe kriminale.

3.Nga auditimi konstatohet, Autoriteti Shitës ka zhvilluar disa ankande me objekt "Shitjen e automjeteve për qarkullim". Llogaritja e vlerës fillestare ankandit është bërë e gabuar, për pasojë vlera është ulur padrejtësisht 50 %, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën prej ***12,580,000 lekë***.

4.Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në përgjithësi nuk ka marrë masa të plota për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare, zbatimin e procedurave të prokurimit publik, zhvillimin e ankandeve dhe kryerjen e inventarëve,e konkretisht:

a.Sistemet e kontrollit të brendshëm,nuk kanë funksionuar në disa komponentë të tij simoskryerjen e plotë të inventarëve fizike dhe të mjeteve të konfiskuara sipas dispozitave të "Kodit Rrugor". Mos dokumentimi i mjeteve të mësipërme në aktivet e institucionit të konvertuara minimalisht në skrap në sasinë prej 17,000 kg, ka sjellë si pasojë të ardhura të munguara që do realizoheshin nga shitja e tyre në vlerën rreth **595,000 lekë.**

b.Nga auditimi konstatohet se, kontraktuesit nuk dokumentojnë shkatërrimin dhe demolimin e mjeteve, për kthimin në skrap të mjeteve motorikedhe moszbatimi i këtij detyrimi nga kontraktuesi, lë shteg për abuzime si, nxjerrja në tregun informal të pjesëve të këmbimit.

5. Nga auditimi i kryer në ankandet e ndryshme për shitje skrapi, cigare e mallra të tjera konstatohet, se në 4 ankande të zhvilluara me vlerë 43,668,150 lekë ka marrë pjesë vetëm një ofertues duke mos respektuar VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik, kreu V, pika 5.3 , duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Shtetit në vlerën prej ***873,363 lekë***.

6.Nga auditimi për zbatimin e kontratave për shitjen e skrapit u konstatuan shkelje të detyrimeve kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara në marrë dhëniet midis palëve, kështu në dy raste u konstatua shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetine shtetit në shumën **659,383 lekë**, për të cilat është rekomanduar marrja e masave për zhdëmtim

[1] ***ISSAI 1320:*** *Përcaktimi I materialit për n gakonteksti përfshin gjykimin profesional të audituesit, i cili ndikohet ngakuptueshmëria që ka audituesit nga njësisë, procedurave të vlerësimit të riskut, si dhe natyrës dhe shkallës së shkeljeve të konstatuara*

Opinion i kualifikuar:
Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në DPRMSH, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion të kualifikuar.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Autoriteti Shitës ka zhvilluar disa ankande me objekt "Shitjen e automjeteve për qarkullim", përcaktimi i vlerës së tyre për t'u shitur në ankand është bërë duke u bazuar në udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 75, datë 13.03.2014 "Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në rezervat materiale të shtetit si pasojë e konfiskimit, duke zbritur 50% si koeficient të amortizimit, për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo mënyrë llogaritje nuk ka lidhje me VKM nr.1242, datë 16.12.2009 "Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit dhe procedurat e zhvillimit të ankandit...", i cili ka dalë në zbatim të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil" i ndryshuar. Ky vendim ka për objekt administrimin dhe shitjen e mjeteve që dalin tepër, mbas miratimit të listës së mjeteve që mbeten në pronësi të institucioneve dhe që do të shiten me ankand, funksionarëve publikë ose nëpunësve civilë të administratës, pjesë e institucionit. Përdorimi i kësaj reference (udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 75, datë 13.03.2014) në 2 ankande të zhvilluara me objekt "Shitjen e 88 mjeteve për qarkullim dhe 22 motoçikletave" me fond limit 12,580,000 lekë, nga 25,160,000 lekë që është vlera e tyre reale, ka ulur padrejtësisht vlerën përmë pak 50 %, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në shumën prej ***12,580,000 lekë,*** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

1.1 Marrjen e masave për shfuqizimin e Udhëzimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 75, 13.03.2014 në mënyrë që vlera e mjeteve për qarkullim të llogaritet si gjithë mallrat e tjerë të sekuestruar dhe konfiskuar sipas përcaktimeve në ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin Publik" dhe VKM nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar, si dhe të përcaktohen udhëzime të tjera nga Ministria e Mbrojtjes për shitjen e mjeteve për qarkullim sipas vlerës reale të tyre.

Menjëherë

2.Nga auditimi, për vitet buxhetore 2014,2015,2016 dhe 2017, me objekt "Mbi administrimin e marrjes në dorëzim të mjeteve të konfiskuara nga Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit dhe vazhdimësia e procedurave të tyre", rezultoi se, shumë mjete gjenden në pikat e bllokimit dhe ato të ruajtjes, në Komisariate apo në Drejtoritë e Policive Vendore për shkaqe, penale ose administrative, të cilat jo vetëm nuk janë dorëzuar në kohë, por janë pranuar nga DRRMSH, me mangësi në dokumentacionin shoqërues të kërkuar,(numri i shasisë, targa dhe të dhëna të tjera për pronësinë), siç përcaktohetnë Ligjin nr.130/2012 "Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga policia e shtetit *deri në datën 30.12.2010*". Më pas nga Ministri i Brendshëm, janë miratuar disa akte administrative, të cilat nuk e kanë zgjidhur situatën, për shkak të mangësive dhe vakumeve juridike që ato mbartin si edhe me ndryshimin e kalimit të DPRMSH në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes në bazë të VKM nr.9, datë 12.01.2018 "Për një ndryshim në vendimin nr.501, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e

fushës së përgjegjësisë shtetërore së Ministrisë së Mbrojtjes ", duke i humbur efektet juridike, të cilat janë si më poshtë vijon ;
-Udhëzimi i përbashkët nr.313, datë 12.07.2013 të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit "Për procedurat e kalimit dhe çregjistrimit të mjeteve nga mjediset e Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse dhe ato të Policisë kufitare dhe Migracionit";
Për sa më sipër, nga auditimet e praktikave shkresore dhe dosjeve fizike, u evidentua se, me gjithë miratimet dhe ndryshimet e akteve të mësipërme, *situata vazhdon të jetë kaotike*, pasi nga ana e Policisë së Shtetit, nuk disponohen dokumentacione shoqëruese për mjetet e bllokuara për arsye penale ose administrative. Këto mjete pasi qëndrojnë për një kohë relativisht të gjatë në pikat e bllokimit të Drejtorive të Policive Vendore, dalin jashtë funksionit për qarkullim, deri në degradim si hekurishte. Nga ana e DPRMSH, këto mjete merren në çdo kohë dhe në çdo formë, me dokumentacion jotë plotë, në disa raste edhe pa dokumentepërkatëse, si dhe në disa raste pa kuadruar dokumentacionin me gjendjen fizike tëmjeteve si nga pala dhënëse dhe ajo marrëse, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore dhe administrative të mësipërme, sidhe me ligjin nr.10296, datë 07.08.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, ***duke krijuar në këtë mënyrë dritë hije për abuzime dhe mashtrime nga të dyja palët,*** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 76-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
2.2. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes tek e cila ka kaluar në vartësi DPRMSH, të shfuqizohen aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërme, "Mbi administrimin e marrjes në dorëzim të mjeteve të konfiskuara nga Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit dhe vazhdimësia e procedurave të tyre" dhe hartimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore, duke përcaktuar saktë dhe qartë, përgjegjësitë e secilit institucion shtetëror të përfshirë në këtë fushë.

Menjëherë
3. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materialeve të Shtetit (DPRMSH) ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme, pas daljes së VKM nr.9, datë 12.01.2018 "Për një ndryshim në vendimin nr.501, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore së Ministrisë së Mbrojtjes ", ka kaluar në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.
-DPRMSH, për çdo vit, ka zhvilluar procedura prokurimi me objekt "Blerje mallra rezervë shteti (ushqimore dhe industriale)", konkretisht të planifikuara nga buxheti i shtetit, respektivisht për vitin 2014, vlera prej 6,000,000 lekë pa tvsh, për vitin 2015 vlera prej 7,132,000 lekë pa tvsh, për vitin 2016 vlera prej 2,087,000 lekë pa tvsh dhe për vitin 2017 vlera prej 2,000,000 lekë. Në total shuma e prokuruar është gjithsej 17,219,000 lekë pa tvsh, Vlerat dhe sasitë e mallrave ushqimore të prokuruar për çdo vit, nuk kanë mundësuar as plotësimin e pjesshëm të limitit minimal të mallrave rezervë materiale shtetërore, siç përcaktohet në VKM nr.1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", pasi fondet vjetore, të planifikuara nga MF (buxheti i shtetit), janë të pamjaftueshme për të plotësuar sasitë sipas artikujve të përcaktuar në aktin normativ ligjor të mësipërm të Këshillit të Ministrave. Ky fakt tregon se, fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, është objektivisht i pamundur për plotësimin e sasive të përcaktuara në kufirin minimal për mallrat rezervë shtetërorë, si rrjedhojë DPRMSH, tenderuar mallra që plotësojnë deri 10% të nevojave, duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore ",ku përcaktohen nevojat në kufirin minimal të mallrave ushqimorë dhe jo ushqimorë**,,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 30-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
3.3. Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materialeve të Shtetit, të shfuqizojë VKM nr.1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", dhe të marrë masa për hartimin e një akti të ri nënligjor, i cili të përmbushë dhe të realizojë, objektin për plotësimin e sasisë minimale për mallrat rezervë shtetërorë, në përmbushje të performancës, të institucionit të DPRMSH.

Menjëherë

4. Nga auditimi konstatohet se, ankandet e zhvilluara me objekt shitje mjete për qarkullim, pas çdo dështimi,proceduratkanë rifilluar dhe rishpallur përsëri me të njëjtin vlerë deri në ndryshimin e gjendjes së tyre fizike dhe klasifikimin "shitje mjete për skrap".
Në të gjitha rastet e dështimit të ankandeve me objekt "shitjen e mjeteve" për qarkullim, (Autoriteti Shitës), mjetet e klasifikuara për qarkullim nuk janë klasifikuar sipas kërkesave të pikës 6/c, ç të VKM-së nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: "*Kur për objekte të shpallur dy herë për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerjen e tyre, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër më të ulët se VAM-i fillestar. Ulja e VAM-it bëhet 20%. ...Në rast se edhe pas kësaj uljeje, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerje, VAM-i ulet deri në 20% nga VAM-i i fundit, për çdo shpallje deri sa vlera të arrijë 30% të VAM-it fillestar të ankandit*". Ky mosveprim, është në kundërshtim me bazën e mësipërme ligjore, ku mjete të rregullta për qarkullim, të denatyrohen dhe klasifikohen për skrap dhe të shiten nën vlerën reale të tyre, duke sjellë të ardhura të konsiderueshme të munguara për Buxhetin e Shtetit**,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
4.4. Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti Shitës, të përcaktojnë ndryshime në dispozitat ligjore në mënyrë që mjetet për qarkullim që nuk shiten për mungesë konkurrence, në ankandin pasardhës çmimi të ulet në masën 20 % të vlerës siç veprohet për mallra të tjera (joskrap), në mënyrë që për mungesë konkurrence mjetet të mos konvertohen për skrap, por të jenë objekt shitje.Nëpërmjet këtij ndryshimi ligjor *autoriteti shitës cakton një VAM tjetër më të ulët se VAM-i fillestar. Ulja e VAM-it bëhet 20%.* Kjo mënyrë veprimi do të mundësojë rriten e të ardhurave nga vlera prej 30,000 lekë që shitet një mjet në formë skrapi, në vlerën prej 96,000 mijë lekë nga shitja e tij si mjet qarkullimi.

Menjëherë

5. Nga auditimi i ankandeve me objekt shitje skrapi, cigare e mallra të tjera konstatohet se, në 4 ankande të zhvilluara me vlerë prej 43,668,150 lekë ka marrë pjesë vetëm një ofertues. Në këto ankande nuk rezulton të jetë propozuar hapi i parë për rritjen e vlerës së deklaruar në ankand minimalisht në masën 2 % të vlerës së ofertës, që në rast se është edhe një ofertues i vetëmduhet të propozohet hapi i parë i ankandit. Si rrjedhojë e mos respektimit të kësaj kërkese, të ardhurat të munguara në buxhetin e shtetit llogariten në shumën prej ***873,363 lekë,*** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
5.5. Nga ana Autoriteti kontraktor të merren masa për të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe termat e referencës që, edhe në kushtet e një ofertuesi të vetëm të respektohen kriteret e pëcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore për propozimin e hapave me qëllim rritjen e vlerës së ofertës, si një mundësi potenciale për rritjen e të ardhurave buxhetore.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Nga auditimi për vitet 2014,2015,2016 dhe 2017, DPRMSH, ka realizuar procedura prokurime, ku pjesën më të madhe e zënë procedura me blerje të vogla, procedurat me objekt investime janë realizuar pranë Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme (për shkak të mungesës të specialistëve). Kështu për vitinbuxhetor 2014 është planifikuar vlera prej 8,747,993 lekë pa tvsh realizuar 8,650,323 lekë pa tvsh ; për vitin 2015 planifikuar vlera prej 14,680,678 lekë pa tvsh realizuar 9,493,773 lekë pa tvsh; për vitin 2016 planifikuar vlera prej 12,358,335 lekë pa tvsh realizuar 11,544,474 lekë pa tvsh dhe për vitin 2017 planifikuar vlera prej 6,923,333 realizuar 5,725,024 lekë pa tvsh. Duke u mbështetur në treguesit e mësipërm evidentohet se, buxheti i shtetit, ka planifikuar vlera të vogla, duke mos mundësuar nga DPRMSH, të paktën të kryheshin shpenzime normale për blerje mallra ushqimore rezervë, si dhe investime me objekt rikonstruksionin e depove të mallrave të cilat rezultojnë në gjendje të amortizuar plotësisht.
-Nga auditimi i disa prej procedurave prokuruese janë evidentuar, mangësi në zhvillimin dhe zbatimin e tyre, pasi burimet njerëzore janë pa trajnuara. Gjithashtu, në përgatitjen e urdhrave të prokurimit, për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017, nga titullari i AK me objekt "*Blerje mallra ushqimorë*", janë pasqyruar dhe çmimi/lekë për njësi, duke orientuar deri diku operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në lidhje me çmimet, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar,"Për prokurimin publik", VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 60 "Urdhri i prokurimit" dhe dokumentat standarde të tenderit, për blerje mallra.
-Nga auditimi, rezultoi se, të gjitha dosjet e vëna në dispozicion, ishin të pa inventarizuara në kundërshtim me ligjin "Për arkivat". Plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar si marrës në dorëzim dhe nga dorëzuesi, nuk janë plotësuar sipas ligjit për arkivat, ka mungesë të dokumentacioneve shoqëruese, veprime në kundërshtim me ligjin "Për Prokurimin Publik", Kreu II, neni 12, pika 3,më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 30-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
1.1. Nga ana e AK, të merren masa që, nëpunësi që do jetë përbërje të grupeve të punës për llogaritjen e vlerës së kontratës, në njësinë e prokurimit dhe në komisionet e vlerësimit të ofertave, Titullari i Autoritetit Kontraktortë përzgjedhë specialistë të fushës së prokurimit të trajnuar sistematikisht pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike, me qëllim rritjen e efiçiencës së përdorimit të burimeve dhe fondeve publike të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.
-Dokumentet e tenderit, të hartohen dhe paraqiten në mënyrë të hollësishme, duke argumentuar çdo kriter të veçantë të vendosur nga anëtarët e njësisë së prokurimit.
-Njësia e prokurimit, të marrë masa për administrimin e plotë të dosjes së prokurimeve si në sistemin on-line të APP-së, por edhe në inventarizimet e tyre, si detyrim i LPP-së dhe me ligjin "Për arkivat".

Vazhdimisht

2.Nga auditimi i kryer në DPRMSH dhe në 8 njësi Rajonale, ndonëse është bërë rilevimi i truallit funksional dhe truallit në nën objekt, këto të dhëna nuk janë evidentuar dhe kontablizuar dhe pasqyruar në bilancet kontabël të njësive rajonale dhe në bilancin përmbledhës të DPRMSH. Kjo mangësi ka sjellë si pasojë që sipërfaqe të konsiderueshme të truallit, të mos regjistrohen sipas urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.680, datë 15.12.2016

pika 4, në të cilin kërkohet "Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të behet brenda muajit Shkurt 2017. Mosregjistrimi i pasurisë është në kundërshtim me VKM-së nr.413, datë 11.07.2007, *"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)"***,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
2.1.Marrjen e masave për evidentimin dhe llogaritjen e sipërfaqes së truallit funksional dhe nën objekt, si dhe kryerjen e veprimeve kontabël për pasqyrimin e sipërfaqes dhe vlerës së kësaj pasurie në bilancin kontabël dhe në partitarin analitik të aktiveve të qëndrueshme të DPRMSH, sipas rilevimit që është bërë në çdo drejtori rajonale.

Menjëherë

3.Nga auditimi, mbi "*Mbi administrimin e marrjes në dorëzim të mjeteve të konfiskuara nga Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit dhe vazhdimësia e procedurave të mëtejshme*", rezultoi se shumë mjete që gjenden në pikat e bllokimit dhe ato të ruajtjes, në Komisariate apo në Drejtoritë Rajonale të Policive vendore për shkaqe dhe arsye penale ose administrative, nuk dorëzohen në kohë dhe me dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit nr.130/2012 "Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga Policia e Shtetit deri në datën 30.12.2010". *Ky ligj i ka dhënë zgjidhje administrimit të mjeteve të sekuestruara, të ndaluara apo të bllokuara ndër vite deri në datën 30.12.2010, për të cilat nuk kishte probleme në ndjekje, në hetim ose verifikime të ndryshme.*
Nga verifikimi i kryer në praktikën shkresore nr.2752, datë 05.02.2014, rezultoi se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoritë e Policisë për çdo Qark, Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë), kanë kaluar në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale Lundër 22 mjete dhe 16 motoçikleta me mangësi në praktikat shkresore shoqëruese të këtyre mjeteve.
Si rrjedhojë e mangësive të mësipërme, u konstatuan mungesë 19 mjete, (*3 autovetura dhe 16 motoçikleta,)* të cilat nuk rezultojnë të jenë dokumentuar në DRRMSH-Tiranë. Kjo tregon për mungesë koordinimi dhe rakordimi midis veprimeve në lëvizjen dhe dokumentimin e mjeteve që hyjnë nga Policia e Shtetit në Drejtorinë Rajonale Rezervave Materiale të Shtetit-Tiranë, mangësi e cila është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 07.08.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", *duke sjellë si pasojë që mjetet jo vetëm të mos jenë objekt shitje, por nga qëndrimi i gjatë të dëmtohen dhe të konvertohen në skrap e për rrjedhojë nuk do arkëtohen në buxhetin e shtetit rreth* ***600,000 lekë****, ndërsa 16 motoçikletat nuk rezultojnë të kenë mbritur nga Policia e Shtetit apo të jenë marrë në dorëzim nga DRRMSH-Tiranë, duke krijuar në këtë mënyrë situata për abuzime dhe mashtrime nga të dyja palët në vlerën rreth* ***1,000,000 lekë,*** me hollësisht është trajtuar në faqen nr.76-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
3.1. Marrjen e masave për rakordimin e veprimeve në praktikat shkresore për 3 autovetura dhe 16 motoçikletamidis Drejtorisë së Policisë Qarkut Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale Lundër, dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

Menjëherë

4. Nga inventari i kryer nga Grupi i Auditimit të KLSH-së, në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale- Tiranë (Lundër), rezultuan tepricë 17 mjete të kategorive të ndryshme

të mbartura nga vitet e mëparshme, fakt që tregon se komisionet e inventarizimit nuk kanë kryer inventar fizik të saktë pasi në asnjë prej inventarëve të kryer për çdo vit nuk janë evidentuar të dhënat individuale(targa dhe numri i shasisë) të mjeteve tepricë të konstatuara nga KLSH. Moskryerja e saktë e inventarëve fizikë është në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV "Sistemi i kontrollit periodik dhe inventarizimi të aktiveve", ku përcaktohet se: "*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike".* Mos dokumentimi i mjeteve të mësipërme në aktivet e institucionit të konvertuara minimalisht në skrap në sasinë prej 17,000 kg, ka sjellë si pasojë të ardhura të munguara që do realizoheshin nga shitja e tyre në vlerën rreth **595,000 lekë,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 23-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
4.1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtoria Rajonale Rezervave Materiale të Shtetit –Tiranë (Lundër), të marrin masa dhe të dokumentojnë në hyrje të aktiveve 17 mjete (autovetura, kamiona dhe mjete të tjera), diferencë (tepricë) e mbarur nga vitet e mëparshme sipas listës nr. 1 bashkëlidhur në kredi të fondeve të veta tepricën e konstatuar në inventarin e datës 29.01.2018 në shumën prej 595,000 lekë.

Menjëherë

5. Nga DPRMSH mbahen pa u shitur (ardhur nga periudhat 1997-2010) 94 mjete motorike të ndryshme pa asnjë dokument si, procesverbali i sekuestrimit, konfiskimit dhe dokumentacioni për çregjistrimin e mjeteve sipas rregullave të përcaktuara në pikën 24, të udhëzimit nr. 74, datë 13.03.2014 të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor. Nga moskryerja e procedurave të shitjes në ankand fillimisht si mjete për qarkullim (edhe për vakum ligjor) pas kalimit të një kohe të gjatë në ambiente të hapura, këto mjete janë zhveshur nga të gjitha pjesët motorike dhe xhenerike, si sistemi i drejtimit, kambio, diferenciali, sistemi i amortizimit, etj duke u kthyer në "mjete për skrap". Tjetërsimi i këtyre mjeteve nga "mjete për qarkullim" në "mjete për skrap", ka sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën rreth ***22,560,000 lekë. (94 x 240,000 lekë/mjet,*** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
5.1. Marrjen e masave për të kërkuar nga Drejtoritë e Policive Vendore, sipas rretheve nga kanë mbërritur këto mjete, dokumentacionin e mundshëm me qëllim, çregjistrimin dhe shitjen e tyre në ankand, konform ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik".

Menjëherë

6.Nga auditimi konstatohet se, DPRMSH gjatë periudhës së auditimi nëpërmjet ankandeve të realizuara, ka shitur për skrap rreth 5.257 mjete të ndryshme (autovetura dhe kamionë) me peshë totale prej 4,732 ton. Në përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit për shitje në formë skrapi të këtyre makinave DPRMSH ka vendosur peshën bruto të makinave sipas manualit të çdo tipi makine por pa analizuar dhe ndarë më pas veçmas peshën e metaleve me ngjyrë dhe metaleve pa ngjyrë. Në manualet përkatëse të makinave përcaktohet pesha e metaleve me ngjyrë si bakri, alumini, duralumini, plumbi, etj si dhe pesha e metaleve pa ngjyrë si çelik apo hekur, të cilat zënë rreth 10 % të peshës totale të skrapit të shitur. Po kështu edhe nga

ballafaqimi i kryer datë 09.04.2018 rezultoi që e gjithë pesha e makinës është shitur si metal pa ngjyrë (hekur) i cili ka çmimin më të ulët të të gjithë metaleve dhe që varion sipas bursës përkatëse nga 23 lekë deri në 30 lekë për kg, ndërsa metalet me ngjyrë kanë çmime disa herë me të larta, si p.sh skrapi i bakrit ka çmimin nga 600-700 lekë/kg dhe skrapet e aluminit, duraluminit, plumbit, shkojnë nga 130-170 lekë kg, ose me një mesatare prej 220 lekë/kg.
Mosrespektimi i standardeve të mësipërme nga Autoriteti kontraktor lë shteg për abuzime si, nxjerrja në tregun informal të pjesëve të këmbimit dhe të ardhura të munguara në vlera të konsiderueshme për buxhetin e shtetit pasi çmimet e metaleve me ngjyrë janë disa herë më të larta se vlera e skrapi i hekurit.
Nga sa më sipër arrijmë në konkluzoion, që nëpërmjet mënyrës se si DPRMSH ka përllogaritur vlerën fillestare të ankandit të makinave të shitura për skrap, buxhetit të shtetit i është shkarkuar një humbje potenciale minimalisht rreth 100,000,000 lekë. (4,732 ton x 10 % x 220 lekë/kg, trajtuar në faqen 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
6.1. Marrjen e masave për të përcaktuar në nenin 8 të kontratës, grupin e punës nga Drejtoritë Rajonale apo nga DPRMSH, me qëllim monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës dhe veçanërisht të shkatërrimit/demolimit të mjeteve, për përcaktimin e sasisë së metaleve me ngjyrë si pjesë përbërëse e mjeteve (disqe alumini, blloku i motorit, testato, kofano, etj) me qëllim rritjen e të ardhurave buxhetore dhe mos tregtimin si pjesë këmbimi në tregun informal si një mënyrë përfitimi e padrejtë nga shoqëritë sipërmarrëse, të interesuara në këtë fushë, si dhe ruajtjen e mjedisit.

Menjëherë

7.Në Drejtorinë Rajonale Rezervave Materiale të Shtetit-Tiranë (Lundër), të gjitha mjetet e konfiskuara që kanë hyrë janë të pajisura me targën e Republikës së Shqipërisë apo targa të shteteve të huaja. Nga auditimi konstatohet se, mjetet e shitura në formë skrapi janë bërë dalje së bashku me targat e tyre, pa marrë asnjë konfirmim në se janë çregjistruar nga DPSHTR. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Për Kodin Rrugor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.1, datë 18.01.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor", lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga zotëruesi i mjetit, kur kalojnë për skrap apo eksportim jashtë shtetit, cilësohet: "*Ana e interesuar, zotëruese e një automjeti, motomjeti, rimorkio, ose që mban titullin e zotëruesit, duhet që brenda 10 ditëve të njoftojë Degën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për shkatërrimin, skrapimin ose eksportimin përfundimtar jashtë shtetit të mjetit, duke kthyer çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit dhe targat. Administratorët e qendrave të mbledhjes dhe shitjes së motomjeteve, automjeteve dhe rimorkiove për t'i çmontuar dhe kthyer në skrap, nuk mund t'i tjetërsojnë, çmontojnë ose shkatërrojnë këto mjete pa përmbushur detyrimet e përcaktuara në pikën 1, për rastet kur zotëruesi ose ai që ka titullin e zotëruesit, nuk i ka përmbushur më parë këto detyrime. Të njëjtat detyrime të përcaktuara në pikën 3, kanë edhe përgjegjësit e qendrave të mbledhjes, ose të vendeve të tjera ku ruhen mjetet e hequra nga qarkullimi sipas nenit 157, në rastin e skrapimit të mjetit të parashikuar nga neni 211, pika 4.*
Po kështu, në nenin 21 të Udhëzimit nr.1, datë 18.1.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre", përcaktohet dokumentacioni që duhet dorëzuar për heqjen e përhershme të mjeteve nga qarkullimi, e konkretisht:

a. aplikimi pranë drejtorisë rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe deklaratën e marrjes së përgjegjësive administrative, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
b. lejen e qarkullimit të mjetit;
c. certifikatën e pronësisë së mjetit;
d. targat e mjetit;
Zyra e regjistrimit, bën shënimet në regjistrin elektronik, kartelën përkatëse dhe në programin informatik të mjeteve;
*Mos dorëzimi i dokumentacionit për çregjistrim krijon kushte të favorshme për tjetërsimin e mjeteve nga mjete për skrap në mjete për qarkullim, veprim i cili përbën shkelje të rendë të "Kodit rrugor" dhe krijim mundësish për përfitime të paligjshme nga subjektet e shpallura fituese në ankandet e shitjes së mjeteve,*më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 51-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
7.1.Në të gjitha ankandet e zhvilluara për shitjen e mjeteve në formë skrapi, Autoriteti Shitës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor të marrin masa konform kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Për Kodin Rrugor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.153, datë 7.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.1, datë 18.01.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe të çregjistrimit të mjeteve rrugore me motor", në mënyrë që para çdo ankandi të bëhet çregjistrimi i mjeteve, heqja dhe depozitimi i targave.

Menjëherë

8.Nga auditimi i kryer në ankandet e zhvilluara për shitjen e mjeteve të klasifikuara "për skrap" konstatohet se një pjesë e ankandeve të zhvilluara me vlerë të llogaritur me çmime më të larta se niveli i çmimit të bursës, kanë dështuar. Për këto raste KVO nuk ka analizuar shkakun e dështimit të ankandit siç përcaktohet në pikën 6/b të VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet: "Autoriteti shitës, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës, por është mjaftuar me anulimin dhe vazhdimin e ankandit të radhës, duke sjellë kosto shtesë në procedurat e ankandeve.
Nga analiza e kryer Grupi i Auditimit të KLSH nxjerr konkluzion se këto ankande kanë dështuar për mungesë të disa dokumenteve ligjore, si dokumentacionin e disponimit të impiantit metal prerës/metal copëtues SHREDDER, certifikatën e regjistrimit në QKB. Fakte që tregon se, këto dokumente janë përdorur rregullisht në ankandet e mëparshme, ku edhe janë shpallur fitues, operatorët ekonomikë konkurruese, të cilët i disponojnë këto dokumente. ***Grupi i auditimit pasi shqyrtoi të gjitha rrethanat e dështimit të ankandeve për mungesë të dokumentacionit ligjor, përsëri mbetet i pashpjegueshëm qëllimi i Autoriteti Kontraktor për llogaritjen e fondit limit me çmime më të larta se bursa, shkak i cili ka sjellëedhe dështimin e ankandeve,*** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
8.1. Autoriteti shitës, duhet të marrë masa për të qenë në korrent të çmimeve të bursës për të mos zhvilluar ankande formale me vlerëdhe çmime më të larta se bursa e skrapit. Kjo mënyrë veprimi është jo efektive, pasi rrit artificialisht shpenzimet për ripërsëritjen e ankandeve, (skrapi nuk ka afat skadencë, që të përshpejtohet shitja).

Menjëherë

9.Nga auditimi, për të gjitha kontratat e lidhura me objekt shitje skrapi, komisionet e ngarkuara për zbatimin e kontratave të ankandit, në asnjë rast nuk kanë peshuar fizikisht skrapin e tërhequr duke krijuar mundësi abuzimi. Kjo për faktin se, përcaktimin e peshës të skrapit për mjetet motorike nga komisionet e miratuara janë llogaritur sipas peshës teorike dhe jo pesha faktike. Po kështu edhe dalja dhe marrja në dorëzim e skrapit, nuk bëhet sipas peshës faktike (reale), por sipas peshës teorike. Kjo mangësi është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011, ku përcaktohet: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative*", **,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 37-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
9.1. Autoriteti Shitës, të marrë masa për vlerësimin e peshës faktike të skrapit, duke vendosur kërkesa që në dokumentat e ankandit dhe në kontratën e lidhur midis palëve, me qëllim marrjen e masave si nga autoriteti kontraktor dhe nga blerësi për të siguruar mjetet dhe mënyrat për peshimin fizik të skrapit dhe bazë për llogaritjen e peshës faktike të shërbejë fatura e peshores së kombinatit metalurgjik, apo dokumenti i doganës për sasinë e eksportuar.

Menjëherë

10. Nga auditimi, është konstatuar se me urdhrin e përbashkët nr.6783, datë 17.12.2010, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, nr.7437/2 prot, datë 27.12.2010 dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, është bërë *kalimi kapital i 1,000 ton skrap hekuri nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve tek Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit*. Palët, me procesverbalin datë 3.02.2011, kanë rënë dakord për marrjen në dorëzim pjesë-pjesë të sasisë të skrapit, duke zhvilluar ankandin për partinë e parë me sasi 400 ton, deri në përfundim të procedurave vijuese të ankandit publik dhe përfundimit të sasisë së kontraktuar.
Në përfundim të ankandit, fitues është shpallur shoqëria "S" shpk, me të cilën është lidhur dhe nënshkruar kontrata nr.16, datë 09.01.2012. Nga kontrata e lidhur, janë evaduar dhe kryer pagesa nga kontraktuesi vetëm për 83 ton skrap, nga sasia prej 400 ton ka mbetur pa evaduar rreth 317 ton skrap (400-87). Shkaqet e moszbatimit të kontratës, kanë qenë pengesat dhe pretendimet e ish-Komunës Kolsh të rrethit Kukës, ku është bërë edhe depozitimi i skrapit. Shqetësues për periudhat në vazhdim janë shpenzimet që kryhen për ruajtjen e tij prej vitit 2010 e në vazhdim, duke bërë që këto shpenzime të kalojnë vlerën që mund të përfitohet nga shitja. Aktualisht vendi i depozitimit të skrapit është në lartësinë mbi 1,200 m mbi nivelin e detit dhe rruga deri në vendin e depozituar skrapi është tepër e amortizuar duke e vështirësuar së tepërmi evadimin e tij**,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 81-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
10.1. Marrjen e masave dhe bashkëpunimin me Bashkinë Kukës për mundësinë e evadimit të skrapit sipas kontratës së lidhur me shoqërinë S, në mënyrë që të evadohet e gjithë gjendja e skrapit në sasinë prej 917 ton (1,000-83 ton), në vlerën rreth 25 milionë lekë, pasi çdo vonesë do të sjellë si pasojë që në të ardhmen shpenzimet do të jenë më të mëdha se të ardhurat e mundshme që mund të realizohen.

Menjëherë

11. Nga auditimi u konstatua se vendet vakante në strukturat e organike të drejtorive rajonale shkaktojnë efekte negative të menjëhershme në mbarëvajtjen e punës dhe ecurine e saj. Kjo

pasi natyra shumë specifike e funksioneve, si jurist, teknolog ushqimor, kimist, apo shofer me automjet special nuk mund të përmbushen nga 1 një punonjës tjetër që nuk ka formimin profesional të duhur për këto pozicione pune. Gjithashtu në Rregulloret e brendshme të DRRMSH, miratuar në datën 24.02.2014, në nenin 2 "Struktura Organike", citohet "... Emërimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të DRRMSH dhe të Agjencive të Rezervave të Shtetit, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm më propozimin e Drejtorit Rajonal.", kjo mënyrë rekrutimi është në kundërshtim me ligjin 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", Kreu IV, më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

11.1.Të merren masa për të rekrutuar punonjës për vendet vakante dhe përshtatur në bazë aftësie dhe cilësitë profesionale të stafit të institucionit, plotësimin e organikës me specialistë të kualifikuar për të rritur performancës realizimin e objektivave të institucionit në kushtet e ndryshimit të vartësisë nga Ministria e Punëve të Brendshme nën juridiksionin e Ministrisë së Mbrojtjes.

11.2. Marrjen e masave për përmirësimin e kontratave individuale të punës dhe përshkrimet e proceseve të punës që duhet të kryhen nga çdo punonjës me qëllim shfrytëzimi maksimal të kohës së punës dhe veçanërisht për proceset e punës trajtimin e mallrave për mbrojtjen e produkteve nga faktorët atmosferike dhe natyrale dhe me afat skadence, procese këto tepër të rëndësishme për administrimin dhe ruajtjen e mallrave ushqimore dhe jo ushqimore.

Menjëherë

12. DRRMSH në shumë raste është shndërruar në një magazinë sendesh ku grumbullohen mallratë ndryshme në sasi tepër minimale (kuti konservash, medikamente të ndryshme, e mallra të tjera), të konfiskuara nga Degët e Tatim Taksave apo Doganat, për të cilat mungojnë përshkrimet për cilësinë apo çmimin e tyre në momentin e sekuestrimit, duke sjellë si pasojë vështirësi në shitjen e tyre, pasi për sasi minimale asnjë subjekt nuk është i interesuar. Kjo mënyrë veprimi ka sjellë si pasojë që DPRMSH të dalë nga funksioni dhe qëllimin kryesor i përcaktuar me ligjin organik. Krahas kësaj theksojmë se, nga mos shitja në afat,produktet ushqimore skadojnë dhe për asgjësimin e tyre kërkohen shpenzime të tjera buxhetore. Objekti i rezervave materiale të shtetit nuk është magazinimi i mbeturinave por i mallrave ushqimore dhe industriale të cilat kanë vlerë përdorimi dhe përbejnë objekt shitje, ose të përdoren edhe si ndihma për përballimin e emergjencave civile apo familjeve me të ardhura minimale sipas rasteve që lejon ligji,më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 28-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

12.1.DPRMSH dhe Ministria e Mbrojtjes, të marrin masa për të mos lejuar magazinimin e mallrave, materialeve apo produkteve ushqimore që nuk sjellin përfitim financiar për buxhetin e shtetit, apo bëhen objekt stoku. Produktet ushqimore në prag skadencë të përdoren për të ndihmuar familjet apo komunitetet e ndryshme me qëllim eliminimin e shpenzimeve të asgjësimit.

Menjëherë

13. Nga auditimi u konstatua se, për përballimin e emergjencave civile ndihmat ushqimore dhe materiale të ndryshmetë shpërndara në disa njësi vendore nuk janë konfirmuar dhe dokumentuar me fletëhyrjet e njësive që janë marrë në dorëzim, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",

duke lënë dyshime se malli nuk ka përfunduar në destinacion**,** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 28-30. të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

13.1.Marrjen e masave për evidentimin e të gjitha rasteve të trajtuara në këtë raport për të konfirmuar dhe dokumentuar në llogarinë 45 "Marrëdhënie me njësitë vartëse të gjitha rastet që nuk janë konfirmuar me fletë hyrje për marrje malli në dorëzim, konform pikës 56 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Menjëherë

14. Nga auditimi pranë DPRMSH, rezultoi se në Drejtorinë Rajonale të Rezervave dhe Materialeve të Shtetit-Korçë, që prej vitit 2009, mbahet gjendje e pa shitur sasia prej 26,993 kg kafe kokërr Arabike e pa pjekur. Kjo sasi kafe është nxjerrë në ankand nga Zyra e Përmbarimit Korçë, e cila është blerë përsëri nga operatori që ishte konfiskuar. Më pas, shoqëria fituese e ankandit "A" shpk, e kthen mallin dhe padit DRRMSH-Korçë, me pretendimin së malli nuk ishte për konsum për shkak të skandencës.

Në vijim, DPRMSH së bashku me DRRMSH-Korçë, kërkoi pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave shqiptare, të cilat ishin në favor të subjektit "A" shpk, duke i dhënë të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit në masën prej 15, 000, 000 lekë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me anë të vendimit nr. 00-2016-2475, datë 20.09.2016, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga DRRMSH-Korçë, duke lënë në fuqi të dy vendimeve të mëparshme. Sa më sipër, në gjendjen aktuale ligjore, vendimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë, është i detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

Për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit DRRMSH- Korçë, ka kryer dy pagesa pjesore në shumën prej 2,400,000 lekë, me urdhër shpenzimet nr.1, datë 11.04.2017; nr. 22 datë 12.04.2017 dhe nr. 88 datë 17.11.2017.. Këto pagesa tregojnë se DPRMSH, e ka njohur dhe pranuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në lidhje me administrimin e artikullit kafe kokërr Arabike e pa pjekur në sasinë prej 26,993 kg. Gjatë vitit 2017, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm i DPRMSH, janë kryer disa analiza të provës të mostrave të kafesë, të cilat kanë rezultuar, *se ky artikull është për konsum publik.*

Në lidhje për minimizimin e detyrimit financiar në zbatim të vendimit të gjykatës së formës së prerë, duhet të kishte *filluar procedura e ankandit për artikullin "kafe kokërr e papjekur", në zbatim të* pikës 16, të nenit 2 të ligjit nr.9900, datë 10.04.2008 "*Për Rezervat Materiale të Shtetit", ku përcaktohet: "Mallrat e konfiskuara" janë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet, që kalojnë në pronësi të shtetit, me vendim të formës së prerë të organit kompetent, si rrjedhojë e kundërvajtjeve administrative, veprave penale apo si pasojë e parandalimit dhe goditjes së krimit të organizuar. Këto mallra administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave materiale të Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi*".

Gjithashtu, në mbështetje të pikës 3, të VKM nr.1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", mallrat rezervë materiale shtetërore që nuk financohen nga Buxheti i Shtetit, në çdo kohë transferohen pa pagesë dhe shiten, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, subjekteve, shtetërore ose private. Kështu, nisur sa më sipër, Ministria e Brendshme, me shkresën nr.7111/1 prot, datë 03.10.2017, ka reaguar se, është kompetencë dhe detyrim ligjor i DPRMSH, për realizimin e procedurës të shitjes së sasisë së kafesë me ankand, gjë që e cila deri në momentin e hartimit të këtij materiali auditimi, nuk është kryer.

Nëpërmjet veprimeve të mësipërme konstatohet se, për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë DPRMSH ka vepruar me dy standarde, së pari*e ka njohur vendimin dhe ka filluar ta*

zbatojë shlyerjen e detyrimit gjyqësor në vlerën prej 15,000,000 lekë, së dyti ndonëse jemi në kushtet e mallit të konfiskuar nuk është marrë asnjë masë për shitjen e sasisë prej *26,933 kg kafe kokërr gjendje në DRRMSH-Korçë.*
Për sasinë prej 26,993 kg kafe kokërr Arabike e pa pjekur, gjendje në Drejtorinë Rajonale - Korçë, nga Drejtori i Përgjithshëm i DPRMSH, janë kryer disa analiza të provës së mostrave të kafesë, pranë institucioneve shtetërore të ligjëruara, si AKU-së Korçë, ISUV-së Tiranë, DRAKU-së Tiranë dhe DSHP Tiranë. Nga të gjitha këto laboratorë pas përfundimit të analizave, sipas raporteve të analizës të provës së kafesë, është pohuar se treguesit organo – lepitke, fiziko – kimikë dhe bakteriologjikë sipas protokollit të tyre institucional janë te lejueshme për konsum publik. (Për kryerjen e këtyre analizave, janë kryer shpenzime nga buxheti i DPRMSH, në shumën prej 16,000 lekë me objekt analiza të mostrës së kafesë).
Në këto kushte nëpërmjet shitjes në ankand të sasisë prej 26,933 kg buxheti i shtetit do të kishte realizuar të ardhura në shumën prej rreth **1,400 mijë lekë, e cila do zbuste sa do pak dëmin e shkaktuar për buxhetin e shtetit nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës.** (llogaritjet janë kryer sipas çmimit të bursës së marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, pa vlerën e TVSH dhe akcizën e këtij malli), më hollësisht është trajtuar në faqen nr.97-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:
Nga ana DPRMSH, të merren të gjitha masat administrative, për të bërë të mundur zvogëlimin për minimizimin e detyrimit financiar, në zbatim të vendimi nr. 00-2016-2475, datë 20.09.2016 i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke filluar procedurën e ankandit për artikullin "kafe kokërr e papjekur", në mbështetje analizave fiziko – kimikë dhe bakteriologjikë, të realizuara në institucionet e specializuara dhe kompetente si dhe në mbështetje të ligjit nr.9900, datë 10.04.2008 "Për Rezervat Materiale të Shtetit" neni 2, pika 16 dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore" pika 3, duke mos humbur kohë fizike, e cila paraqet risk për parametrat cilësorë dhe të humbjes së vetive të tij.

Menjëherë

C. MASA PËR ZHDEMTIMI DËMI

1. Nga auditimi i kryer në ankandin me reference 1A/2015 për shitjen e skrapit të përfituar nga konfiskimi i 40 mjeteve të shoqërisë "B" me peshë 551,986.5 kg. Me shkresën nr.298, datë 25.07.2014, është bërë rishikimi i sasisë nga përfaqësuesi i ARrSH-së duke ndryshuar dhe ulur sasinë fillestare në 540,899 kg, ose më pak për **11,087.5 kg, (**pa ndryshim numri të mjeteve**)**
Nga verifikimi i mëtejshëm për këtë problem nuk u gjend asnjë shkak apo arsye përse është caktuar një person tjetër përfaqësues i ARrSH-së për rivlerësim të peshës, ndërkohë që pesha e tyre është caktuar një here nga komisioni i përbërë me specialist të fushës. Në procesverbalin mbajtur për ndryshimit e vlerësimit fillestar është caktuar E.B, i cili ka qenë edhe në përbërje të komisionit të përbashkët në cilësinë e përfaqësuesit të ARRSH. Caktimi i këtij personi për here të dytë në uljen e peshës përbën konflikt interesi pasi në rastin konkret për çdo dyshim dhe pasaktësi duhej të vepronte një komision tjetër i paanshëm.
Në datën 28.07.2015 komisioni i përbërë nga K.H., A.J, J.S. dhe H.K. ka mbajtur procesverbalin e dorëzimit të disa pajisjeve skrap që përbehen nga kaldajë, autoveturë Nisan, shtyllë metalike, kabinë + skrap-miks, dhe pjesë të platformës peshore me peshë totale prej 6,820 kg. Procesverbali është nënshkruar nga marrësi në dorëzim P.Sh. (përfaqësuesi i shoqërisë kontraktuese). Po në këtë datë këto pajisje janë dorëzuar në Kombinatin Metalurgjik Elbasan me faturën e peshores nr. 165212, datë 28.07.2017, sipas kësaj fature nuk rezulton të jetë dorëzuar platforma e peshores. Në këtë rast ndonëse mungon "platforma

e peshores" sasia e skrapit të dorëzuar përsëri është 6,820 kg, po kaq sa është edhe në procesverbalin e dorëzimit (platforma e peshores sipas aneksit të kontratës ka peshën prej 9,056 kg). Nëpërmjet këtyre veprimeve është shkarkuar padrejtësisht dhe në mënyrë të pajustifikuar artikulli "platformë peshore" me peshë 9,056, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga shoqëria, me pasojë dëm ekonomik për të ardhurat buxhetore në vlerën prej **419,383 lekë** (9,056 x 46.31), më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 54-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave për fillimin e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës prej **419,383 lekë**, për sa përfituar padrejtësisht shoqëria "Sh" në zbatimin e kontratës së lidhur midis palëve për shitje skrapi të konfiskuar.

Menjëherë

2.Nga auditimi i kryer në ankandin e zhvilluar me referencë 1A/2014 për shitjen e 2,642 mjete në sasinë prej 1,762,071 kg, me vlerë fillestare 44,227,982 lekë pa tvsh, u konstatua se, në Komisariatin e Malësisë së Madhe gjatë tërheqjes së mjeteve në formë "skrap" rezultuan dy automjete mungesë, për të cilat DPRMSH ka njoftuar SHÇBA të Ministrisë së Punëve të Brendshme për nxjerrjen e përgjegjësisë. Deri sot nuk ka asnjë informacion për masat e mara, për zhdëmtimin e mungesës së konstatuar në formën "mjet qarkullimi"minimalishtnë vlerën **240,000 lekë (**çmimi i mesatar i mjeteve për qarkullim shitur në ankand**),** më hollësisht është trajtuar në faqen nr. 46-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë rekomandoj:

Marrjen e masave për të kërkuar në mënyrë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik nga personat përgjegjës të ngarkuar me administrimin e mjeteve në Komisariatin Policisë në Malësinë e Madhe në shumën **240,000 lekë**, nga P.K dhe Rr.F. në cilësinë e përgjegjësve materiale, respektivisht nga 120,000 lekë, të cilët kanë nënshkruar procesverbalin e mungesës gjatë tërheqjes së mjeteve nga shoqëria fituese e ankandit në datën 09.09.2014.

D.MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 6, pika 7 të Ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", dhe VKM nr.9, datë 12.01.2018 "Për një ndryshim në vendimin nr.501, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore së Ministrisë së Mbrojtjes ", për të metat dhe mangësitë e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Ministrit të Mbrojtjes shkarkimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH z. I.D., pasi:

a.Përmos marrjen e masave për realizimin e procedurës së ankandit të94 mjeteve motorike, të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit gjatë viteve të mëparshme, të cilat mbahen gjendje në Drejtorinë Rajonale Rezervave Materiale të Shtetit – Tiranë. Për pasojë me kalimin e kohës këto mjete janëamortizuar dhe zhveshur nga të gjitha pjesët motorike dhe xhenerike, si sistemi i drejtimit, kambio, diferenciali, disqe,etj duke u kthyer në "mjete për skrap". Tjetërsimi i mjeteve në skrap përbën të ardhura potencialisht të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën prej ***22,560,000 lekë. (94 x 240,000 lekë/mjet)***

b.Nga auditimi konstatohet se, DPRMSH gjatë periudhës së auditimi nëpërmjet ankandeve të realizuara nga DPRMSH dhe Degët Rajonale të Rezervave, janë shitur për skrap rreth 5,200 mjete të ndryshme (autovetura edhe kamionë) me peshë totale prej 4,732 ton. Në përcaktimin e vlerës fillestare të ankandit të shitjes për skrap të mjeteve DPRMSH ka vendosur peshën bruto të këtyre makinave sipas manualit të çdo tipi makine, minus peshën e

materialeve jo skrap (27 %) por pa analizuar dhe ndarë më pas veçmas peshën e metaleve me ngjyrë dhe metaleve pa ngjyrë. Në manualet përkatëse të makinave përcaktohet pesha e metaleve me ngjyrë si bakri, alumini, duralumini, plumbi, etj si dhe pesha e metaleve pa ngjyrë si çelik apo hekur zë rreth 10 % të peshës totale të skrapit të shitur.
Po kështu edhe nga ballafaqimi përfundimtar midis subjektit të audituar dhe grupit të auditimit në ambientet e KLSH-së, më datë 09.04.2018 rezultoi që e gjithë pesha e makinës është shitur si metal pa ngjyrë (hekur) i cili ka çmimin më të ulët të të gjithë metaleve dhe që varion sipas bursës përkatëse nga 23 lekë deri në 30 lekë/kg, ndërsa metalet me ngjyrë kanë me çmime disa herë me të larta, p.sh skrapi i bakrit shkon, nga 600-700 lekë/kg dhe skrapet e aluminit, duraluminit, plumbit, shkojnë nga 130-170 lekë/kg.
Mosrespektimi i standardeve të mësipërme nga Autoriteti shitëska lënë shteg për abuzime, duke nxjerrë në tregun informal pjesë të këmbimit dhe për pasojë të ardhura të munguara në vlera të konsiderueshme për Buxhetin e Shtetit.

Nga sa më sipër arrijmë në konkluzoion, që nëpërmjet mënyrës se si DPRMSH ka përllogaritur vlerën fillestare të ankandit të makinave të shitura për skrap, buxhetit të shtetit i është shkarkuar një humbje potenciale minimalisht rreth 100,000,000 lekë. (4,732 ton x 10 % x 220 lekë/kg çmimi mesatar), më hollësisht është trajtuar në faqen nr.30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

c. Drejtori z.I D në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Shitës nuk ka kërkuar në asnjë rast konsulencë dhe bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në lidhje me hartimin e kontratave për shitjen e mjeteve për qarkullim, për skrap dhe mallra të ndryshme, të cilat kanë vlera të konsiderueshme nga 5 deri 40 milionë lekë, duke sjellë si pasojë që, mjetet në formë skrapi të shiten pa marrë konfirmim në se janë çregjistruar nga DPSHTR, në kundërshtim me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 "Për Kodin Rrugor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr.153, datë 7.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.1, datë 18.1.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor", i ndryshuar, lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet nga zotëruesi i mjetit, kur këto të fundit kalojnë për skrap. Kjo mënyre veprimi lë shteg për tjetërsim të mjeteve nga objekt skrapi në mjete për qarkullim apo edhe favorizim për veprimtari të jashtëligjshme.
- z. I D në cilësinë nënshkruesit të kontratës në ankandin me nr. Reference 1 A/2014, - z. I D në cilësinë nënshkruesit të kontratës në ankandin me nr. Reference 1 A/2014,dhe kontratës së shitjes së mjeteve të rënda sekuestruar shoqërisë "B." për sasinë 2,303 ton me vlerë totale 78,821 mijë lekë ndonëse në nenin 8 "detyrimet e kontraktuesit" ka përcaktuar realizimin e procesit të tjetërsimit nëpërmjet shkatërrimit/demolimit të mjeteve për skrap në impiantin metalprerës, metalcopëtues SHREDDER, nuk ka përcaktuar personin që do monitorojë këtë proces gjatë fazës së zbatimit dhe tjetërsimit të kontratës nga kontraktuesi, duke lënë shteg për abuzime dhe nxjerrje të pjesëve të këmbimit në tregun informal.

-Nga auditimi i kryer në ankandet e zhvilluara për shitjen e mjeteve të klasifikuara "për skrap" apo mallra të ndryshme, cigare etj, konstatohet se një pjesë e ankandeve kanë dështuar, për të cilat nuk ka kërkuar shkaqet e anulimit të ankandeve siç përcaktohet në pikën 6/b të VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet: "Autoriteti shitës, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës, por është mjaftuar me anulimin dhe vazhdimin e ankandit të radhës, duke sjellë kosto shtesë në procedurat e ankandeve.

D. INDICIE PENALE

Nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të vijojë puna për përcjelljen e Raportit Përfundimtar i Auditimit si indicie penale në organin e Prokurorisë, duke i kërkuar veçanërisht këtij organi thellimin e hetimeve penale në lidhje me çështjen e shitjes, nga DPRMSH dhe Degët Rajonale të Rezervave, të rreth 5,200 automjeteve të ndryshme për skrap, për të cilat nga përllogaritjet e grupit të auditimit rezulton se i është shkaktuar buxhetit të shtetit një humbje potenciale prej minimalisht 100,000,000 lekë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

[shqiptarja.com]